



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Në mbështetje të nenit 6, pika 1, nënpika 1.3 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, lidhur nenit 13, të Rregullores Nr. 01-110/04-14194, për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim për më pak se një (1) të Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Raportit final të komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave, për dhënien në shfrytëzim për më pak se një (1) vit të pronës së paluajtshme të komunës, Kryetari i Komunës së Gjakovës lidh këtë:

K O N T R A T Ë

Për dhënien në shfrytëzim për më pak se një (1) vit të pronës së paluajtshme të komunës së Gjakovës

E hartuar me datë 30 06.2022 në Gjakovë, lidhur në mes të palëve kontraktuese, si më poshtë:

PALËT KONTRAKTUESE:

- 1. Ardian Gjini, Kryetari i Komunës së Gjakovës i cili e përfaqëson Komunën**, si dhënës i pronës së paluajtshme të Komunës, në shfrytëzim për më pak se një (1) vit nga njëra anë dhe
- 2. Meriton Deda** – përfaqësues i biznesit “Lounge Bar Le Corbusier” Sh.p.k, nga Komuna e Gjakovës, Rr. “Mazllom Lakuci” pn, me numër të biznesit 810127515, përfitues - shfrytëzues i pronës së paluajtshme të Komunës, nga ana tjetër.

Neni 1

Objekti i kontratës

Objekt i kësaj kontrate është dhënia në shfrytëzim për më pak se një (1) vit, e pronës së paluajtshme të Komunës së Gjakovës, për shfrytëzimin e hapësirës publike para lokalit afarist – kafiterisë, për vendosjen e tavolinave, me qëllim të shfrytëzimit për terasë të lokalit, me sipërfaqe prej 20 m² në Rr. “Nëna Terezë” në afërsi të lumit Krena, sipas kërkesës së prezantuar nga pala.

Neni 2

Kohëzgjatja e kontratës

Palët kontraktuese janë pajtuar që afati i shfrytëzimit të hapësirës së lartcekur të jetë nga dita e nënshkrimit deri me datë 01.10.2022.

Pas kalimit të afatit të paraparë në pikën 1, të nenit 2, të kësaj kontrate ose ndërprerjes së parakohshme të kontratës, e drejta e shfrytëzimit i kthehet pronarit, Komunës së Gjakovës.



Neni 3
Lartësia e çmimit dhe afati i pagesës

1. Çmimi për periudhën mujore caktohet në vlerë prej 3.00€ për m², për sipërfaqen e kërkuar prej 20 m², për një (1) muaj llogaritet në shumë totale 60 €.
2. Shfrytëzuesi obligohet që pagesën për hapësirën e marrë në shfrytëzim ta paguaj në xhirollogarinë e Komunës së Gjakovës, në fillim të çdo muaji, nga data 01 më së largu deri më 05 të muajt vijues.
3. Në rast të mos pagesës së borgjit, ndaj shfrytëzuesit do të merren masa ndëshkimore, sipas procedurave ligjore në fuqi, duke e llogaritur edhe kamatën.
4. E drejta e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme të Komunës nuk mund të bartet në shfrytëzim te personat e tretë nga qiramarrësi.

Neni 4
Dhënia e pronës së paluajtshme dhe mënyra e shfrytëzimit

1. Komuna garanton se objekti i kësaj kontrate nuk ka të meta juridike.
2. Shfrytëzuesi nuk mund t'a ndryshojë ushtrimin e veprimtarisë së vet, por pronën që e ka marrë në shfrytëzim duhet ta shfrytëzojë vetëm për qëllimin e kërkuar ashtu siç e ka të paraparë më këtë kontratë.
3. Shfrytëzuesi obligohet që të mirëmbajë dhe të kujdeset për gjelbërimin përreth dhe pastërtinë e mjedisit ku vepron.
4. Shfrytëzuesi obligohet që paraprakisht të merr pëlqimet tek Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit për vendosjen e ndonjë objekti të përkohshëm.

Neni 5
Mbikëqyrja e kontratës

1. Prona e paluajtshme nuk e ndërron titullarin juridik, pronar i saj mbetet Komuna e Gjakovës dhe si e tillë ajo nuk mund t'i bartet personit të tretë në shfrytëzim, nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.
2. Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit mbikëqyr realizimin e kësaj kontrate.

E K
e Gja
Kon
Drejtoria
për Urbanizëm
dhe Mbrojtje të Mjedisit

Neni 6
Shkëputja e njëanshme e kontratës

1. Shkëputja e kontratës në mënyrë të njëanshme bëhet në rast të mospërbushjes së obligimeve, nga shfrytëzuesi i pronës së paluajtshme, siç është përcaktuar në këtë kontratë.
2. Komuna e Gjakovës ka të drejtë që të shkëpusë kontratën para kalimit të afatit të caktuar, në rast kur i nevojitet hapësira e dhënë në shfrytëzim për investime apo për realizimin e ndonjë projekti të caktuar.

Neni 7
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Palët zotohen se do t'i përmbahen kësaj kontrate dhe në rast të mosmarrëveshjes eventuale ndërmjet palëve kontraktuese, palët do të bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore. Në rast se nuk arrihet ndonjë marrëveshje në mes të palëve, atëherë kontesti do të zgjidhet në Gjykatën kompetente.

Neni 8
Kopja e kontratës

Kjo kontratë është përpiluar dhe nënshkruar në 3, (tri) kopje të njëjta identike prej të cilave nga 1, (një) kopje i takon secilës palë kontraktuese, kurse (1) një Drejtorinë përkatëse.

Neni 9
Hyrja në fuqi

Kjo kontratë hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët kontraktuese.

PALËT NËN SHKRUESE


Ardian Gjini
Kryetar i Komunës së Gjakovës

Meriton Deda

Lounge Bar
LE CORBUSIER SH.P.K